



QENDRA KOMBETARE E REHABILITIMIT TE PAK

2014

Qendra Kombetare e Rehabilitimit te Personave me Aftesi te Kufizuar ne Shqiperi

Qendra Kombetare e Rehabilitimit te Personave me Aftesi te Kufizuar ndodhet 7 km nga qendra e Tiranes me nje siperfaqe 13,000 m² e vetmja qender kombetare per nga lloji dhe rendesia. Personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi dhe ne rajon do ti drejtohen Qendres Kombetare te Rehabilitimit te Personave me Aftesi te Kufizuar per rehabilitimin gjitheperfshires dhe sherbimet sociale, fale konceptit qe qendron ne partneritetin shtet – NGO, bashkepunimin e ngushte dypalesh me sektorin privat, bashkepunimin nderkombetar dhe siper marrjen sociale. Kjo eshte e para qender kombetare ne Shqiperi e personave me Aftesi te Kufizuar. Ne fillim, para 15 vitesh kjo ishte nje enderr per personat me aftesi te kufizuar, nje enderr e larget e cila u be realitet ne 31 Tetor 2014, dita kur u be edhe inagurimi i kesaj qendre.



Pamje nga dita e inagurimit te QKRPAK

Qendra Kombetare e Rehabilitimit te Personave me Aftesi te Kufizuar do te behet institucioni kryesor per risocializimin e personave me aftesi te kufizura ne Shqiperi dhe ne Ballkanin Jug-lindor. Qendra Kombetare e Personave me Aftesi te Kufizuar do te beje marreveshje me organizatat e shoqerise civile nga Shqiperia, Ballkani dhe Europa, duke ju dhene atyre lehtesira qeraje per aktivitete dhe evente te ndryshme dhe mundesi qe te angazhohen ne nje dialog gjitheperfshires persa i perket angazhimit qytetar , shoqatave te bamiresise, vullnetarizmit, bashkepunim me nderaftesine e kufizuar , asistence teknike dhe kooperim ndermjet organizatave te te verberve dhe organizatave te shoqerise civile te personave jo me aftesi te kufizuar.

Premisat e Qendres Kombetare te Personave me aftesi te kufizuar jane projektuar qe te sigurojne rehabilitimin baze, trajnimin profesional, veprimtarite sociale te personave me aftesi te kufizuar dhe per te gjithë komunitetin e organizatave joqeveritare ne te gjithë Shqiperine, Cdo vit, afro 3500 persona me probleme shikimi, 300 persona me paaftesi te tjera dhe 500 persona te tjere pa probleme do te perfitojne shkollim, promovim te aftesive te tyre artistike dhe shoqerore, punesim, ndertimin e kapaciteteve dhe sherbimet e socializimit cdo vit, sapo qendra te jete funksionale. Nje holl i madh eshte projektuar per te organizuar aktivitate artistike dhe kulturore, organizimi i ekspozitave nga personat me aftesi te kufizuar, organizimi i konferencave shkencore dhe seminareve persa i perket ceshtjeve te shendetit,si dhe parandalimi i verberise.



Pamje nga salla e konferencave

Qellimet e qendres Kombetare te Rehabilitimit te personave me aftesi te kufizuar

Perfundimi i kesaj godine do te lejoje stafin e Qendres Kombetare te Personave me aftesi te kufizuar ne realizimin e menjehershem te pikave si me poshte vijon:

1. Te rrise poziten e Qendres Kombetare te Rehabilitimit te Personave me Aftesi te Kufizuar si institucioni kryesor per personat me aftesi te kufizuar
2. Te siguroje sherbimet per rehabilitimin, mundesite e shkollimit, trajnimet profesionale per personat me aftesi te kufizuar.

3. Te krijoje per here te pare qendren e burimeve shkencore per organizimin e kerkimeve shkencore, te dhena, konferenca, seminare per probleme shendetesore, parandalimin dhe trajtimin e tyre.

4. Te behet nje qender reference rajonale per Ballkanin Jugperendimor, duke promovuar nje numer te gjere sherbimesh per personat me aftesi te kufizuar.

5. Te bashkepunoje me punedhenesit, shkollat, sipermarresit social , institucionet shtetore qendrore dhe lokale me qellim lehtesimin per perfshirjen sociale te te verberve ,promovimin e sherbimeve te komunitetit dhe mundesite e punesimit te te verberve ne nivelin lokal, kombetar e rajonal.



Pamje nga salla e klasave ku do te zhvillohen kurset

Grupi i synuar ose target grupi

- Te gjithë personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi
- 11,000 persona te verber ne Shqiperi qe do te kene mundesine per te siguruar literature ne brail, relief dhe audio.
- Familjet e personave me problem shikimi do te jene perfituesit e drejtperdrejte sepse femijet e tyre ose anetare te tjere te familjes do te integrohen ne shoqeri dhe do te kene autonomi ne levizje dhe orientim.
- Pushteti qendror dhe lokal, shkollat, spitalet dhe disa institucione te tjera te cilat do te pajisen me aksesore te reliefit ne menyre qe te lehtesoje orientimin dhe levizjen e personave me aftesi te kufizuar kur vizitojne keto institucione.
- Organizatat e shoqerise civile nga Shqiperia, Ballkani dhe Europa.

Perqasja

Perqasja kryesore e qendres Kombetare te Rehabilitimit per personat me aftesi te kufizuar ne Shqiperi mbeshtetet ne 7 fusha thelbesore:

- ✚ Aftesite e jetes (gatimi, pastrimi, kujdesi dhe veshja)
- ✚ Orientimi dhe levizja
- ✚ Teknologjia e adaptueshme
- ✚ Aftesite para-profesionale
- ✚ Brail dhe relief
- ✚ Terapite e kombinuara
- ✚ Aftesite e gjuheve te huaja



Pamje nga hollet e godines

Studentet dhe stafi do te hartojne nje plan qe te perputhet me nevojat specifike te individeve. Studentet mund te perfshihen ne program disa here ne vit dhe kjo varet nga datat e disponueshme. Kohezgjatja do te percaktohet nga kerkesat individuale dhe progresi, me nje qendrim deri ne nje vit per nje kapacitet maksimumi 250 persona.



Pamje nga ambientet e restaurantit e te guzhines

Aktivitetet kane per qellim rehabilitimin e funksioneve sociale te personave si dhe permbushjen e nje jete te pavarur.

Qendra Kombetare e Personave me Aftesi te Kufizuar po planifikon qe te zgjeroje trajnimet e saj duke siguruar trajnime profesionale per personat me probleme ne shikim ne profesionet e meposhtme:

- 🚦 psikoterapi,
- 🚦 perpunim tekstesh,
- 🚦 sekretari,
- 🚦 operator ne call center,
- 🚦 gjuhe te huaja,
- 🚦 punime me dore,
- 🚦 kozmetike,
- 🚦 tapiceri,
- 🚦 rritjen e luleve,
- 🚦 mbjellje,
- 🚦 asistence teknike me IT dhe mjetet e komunikimit.

Cdo vit, rreth 800 persona me probleme ne shikim do te ndertojne kapacitetet e tyre ne qender.

Personat qe shikojne marrin shume informacion nepermjet te parit, menyra e vetme e perthithjes se informacionit nga te verberit eshte nepermjet te ndjerit, pra te prekurit.

Per kete arsye Shoqata e te Verberve te Shqiperise synon te drejtoje ne menyre te pavarur nje qender ne te cilen nxenesit dhe te rinjte do te mesojne shprehite e te kujdesurit per vete dhe ne kete menyre do te jene te dobishem per te jetuar ne nje bote te sigurt dhe qe kujdeset per ta

Institucioni do te punoje me prinderit dhe te afermit e personave me probleme ne shikim. Trajnuesit do te trajnohen ne Qendren Kombetare te Personave me aftesi te kufizuar per nevojat e qeverive lokale dhe organizatave joqeveritare nga shteti. Qendra Kombetare e Personave me aftesi te kufizuara do te jete konsulentja e autoriteteve lokale gjate funksionimit si nje qender rehabilituese per PAK.

STRUKTURA E QENDRES KOMBETARE TE PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR

Qendra Kombetare e personave me aftesi te kufizuar eshte nje qender e dizenuar, e konstruktuar ne pershtatje me nevojat e personave me aftesi te kufizuar, dhe eshte prone e shoqates se te verberve te Shqiperise.

Ndodhet 7 km nga qendra e Tiranes me nje siperfaqe 13,000 m² e vetmja qender kombetare per nga lloji dhe rendesia, duke ofruar sherbime te shumellojshme jo vetem per personat me probleme ne shikim, por edhe per komunitetin, aktoret e tjere sociale ne nivelin kombetar e nderkombetar etj. Do te jete nje qender mikse, qe do te ofroje sherbime te shumellojshme per integrimin dhe mbeshtetjen.

Qe prej vitit 2004 Shoqata e te Verberve te Shqiperise ka dizenuar nje projekt me ekspertize nderkombetare nga shtetet e Europes Perendimore. SHVSH paraqiti dokumentacionin per tender dhe nga tenderi i zhvilluar ku moren pjese disa studio u perzgjodh Construction Studio D&C. Kjo studio hartoi projektin i cili u mbeshtet nga 15 eksperte te fushave te ndryshme si arkitekthe, juriste, ndertues, okuliste, pediater, punonjes social, fiziolog, tiflologe, tiflopedagoge, tifloteknike, tiflofiziolog, etj. Projekti u hartua gjithashtu ne formatin brail dhe relief. Ne ndertese eshte planifikuar qe te jete qendra e rehabilitimit fizik, zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme per personat e verber dhe paleve te tjera te interesuara ne nivelin kombetar dhe nderkombetar. Ne pjesen qendrore do te jete nje holl i madh, nje salle konferencash me nje kapacitet rreth 300 persona, 2 salla te vogla konferencash me nje kapacitet 80 persona secila,

restorant, bar, kuzhine, pishine, sektor per brailin dhe relievin, biblioteke, salla e leximit, holli i logopedise, klasat per kurset profesionale,(Anglisht, Brail, Kompjuter, muzike, manaxhimi i mikroambientit, tiflologjia). Do te jene gjithashtu edhe qendrat administrative(Agjensia per parandalimin e verberise, Instituti i punesimit, Qendra e tiflologjise, Qendra per nje jete te pavarur, qendra per akses ne informacion, kabineti i logopedise, kabineti i okulistikes dhe infermierise, kabineti i librave foles. Kati i trete dhe kati i katert jane planifikuar 42 dhoma hoteli. Gjithashtu kjo qender permban nje magazine prej 226 m2 e cila permban lavanderine dhe bolieret. Ne kete godine ndodhet gjithashtu pishina , sauna, dhoma e mjekut dhe palestra. te verberve te Shqiperise.



Pershtatshmeria per orientim

Qendra Kombetare e Rehabilitimit te PAK do te mbetet shtepia e perhershme e kesaj kategorie.